



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:017069

Datë: 03.07.2018

Numri i dokumentit: 00075568

P. nr.40/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.71/18 të dt.25.01.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **08.06.2018**, në prani të Prokurorit së shtetit Armend Zenelaj dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **H. H.** nga Gjakova, tani me banim në Gjakovë, rr. ..., i biri i K. dhe i nënës F. e gjinisë F., data e lindjes ... në fsh. R. e E. K-Deçan, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 6 fëmijëve.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

I. Nga data e pavërtetuar e gjere me dt. 08.08.2017, në shtëpinë e tij në lagjen ... K-Gjakovë, me qëllim që vetit të sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me dispozitën e nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K., është konstatuar se i pandehuri jashtë njehsorit elektrik nr.32631046, përmes kabllos 3x2.5, duke e anashkaluar kështu regjistrimin e sakte të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar K.-divizioni në Gjakovë i ka shkaktuar dëme në shumën 152,41 euro.

II. Nga data 09.08.2017 e gjere me dt.12.09.2017, në shtëpinë e tij në fsh. R e E. K Deçan, me qëllim që vetit të sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me dispozitën e nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K., është konstatuar se i pandehuri jashtë njehsorit elektrik nr..., përmes kabllos 2x2.5, duke e anashkaluar kështu regjistrimin e sakte të energjisë së

shpenzuar elektrike me ç' rast ndërmarrjes se dëmtuar K.-divizioni ne Gjakove i ka shkaktuar dëme ne shumen 37,20 euro,e qe ne tërësi dem i shkaktuar është 189,61 euro.

- **me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51,52par.5, 73 ,neni 320-81 të KPRK-së dhe neni 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4(katërt) muajve** dhe dënim me gjobë ne shumë prej **200.00 (dyqind) euro**, të cilat dënime nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

E dëmtuara , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.71/18 të dt.25.01.2018, e ka akuzuar të akuzuarin H. H. nga R. e E. K Deçan, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.08.06.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori Armend Zenelaj , lexon aktakuzën PP/II.nr.71/18 dt. 25.01.2018 dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës, por përmirëson të dhënat personale të akuzuar si në procesverbalin e këtij shqyrtimi po ashtu në dispozitat e kësaj aktakuze ku në rreshtin e parë duhet jetë në shtëpinë e tije “ në lagjen ...” K-Gjakovë e jo fshati R. e E. K-Deçan, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari H. H. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët e K. ne njehsorin te cilën e shfrytëzojë, me pranimin e fjalisë jam penduar për veprën e kryer mirëpo një veprim të tillë e kam kryer në pamundësi të pagesës së borxhit ndaj të dëmtuarës të cilët më kishin shkyçur nga rrejtji Elektrik, pas pagesës së të njëjtës nga ana e përmbarruesit është bërë lidhja dhe çdo gjë është në rregull dhe pagesat e borxhit i bëj sipas marrëveshjes me të dëmtuarën . I propozoj gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla , si dhe është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes .

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ky pranim është bërë i pakushtëzuar dhe vullnetarisht Gjkata ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me faktet e ofruara ,provat që i janë bashkangjitur shkresave të lëndës ,sidomos pranimi i fajësisë , është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ,andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 320lidhur me nenin 81 të KPRK-së për të cilën vepër e akuzuari është penalisht përgjegjëse dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjkata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 6 fëmijëve , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , pendimin e shprehur ne gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se e akuzuari më parë nuk ka qene i dënuar, të cilat rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së, Gjkata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 4(katër) muajve, dhe dënim me gjobë prej 200.oo(dyqind) euro, t nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.40/18 më datë 08.06.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.